



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosova - Tax Administration of Kosovo



ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS (ATK) - Divizioni i Ankesave – në përbërje të panelit shqyrtues: Ilona Mrasori kryesuese, Ramadan Ahmeti dhe Bashkim Paçarizi anëtarë të panelit, duke vendosur në çështjen administrative tatimore, sipas ankesës së subjektit [redacted], me numër unik identifikues NU [redacted] me adresë të biznesit [redacted] e dorëzuar në Divizionin e Ankesave me datë 11/11/2022 me nr. protokollit 473/22, kundër vendimit mbi Njoftim-Rivlerësimet për obligim tatimor, të lëshuara nga Drejtoria Rajonale Mbledhja e borxheve, në bazë të nenit 77 të Ligjit nr. 03/L-222 „Për Administratën Tatimore dhe Procedurat”, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa në procedurë me nr.473/22 e subjektit [redacted], me NUI [redacted] me adresë: [redacted] në mbështetje të Nenit 132 Paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 “Për Procedurën Administrative” në lidhje me paragrafin 2 të nenit 89 të Ligjit Nr. 03/L-222 “Për Administratën Tatimore dhe Procedurat”

II. Procedura e ankesës nuk ndërprehet obligimin e tatimpaguesit për pagesë të detyrimeve tatimore (tatim, ndëshkime dhe interes) në përputhje me nenin 9, paragrafin 1 të Ligjit Nr. 04/L-102 për Ndryshim Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat

A r s y e t i m

Tatimpaguesi ka dorëzuar ankesë në Divizionin e Ankesave më datë 11/11/2022, ndërkaq Njoftim Rivlerësimet nga Mbledhja e borxheve e ka pranuar më datë 28/10/2022, që për rrjedhojë ankesa është parashtruar në afatin ligjor prej 30 ditësh e përcaktuar me nenin 77.2 të Ligjit Nr. 03/L-222 “Mbi Administratën dhe Procedurat Tatimore”.

Biznesi [redacted] është regjistruar ne ARBK me [redacted] ndërsa si deklarues vullnetar ne TVSH është regjistruar 11/01/2018. Ky subjekt si aktivitet kryesor ka tregtinë me shumice te papërpunuar, lëkurave dhe artikujt tjerë prej lekure.

Tatimpaguesi në ankesën e datës 11/11/2022, konteston njoftimin për vlerësim nga Mbledhja e borxheve për personin përgjegjës i datës 28/10/2022 ne te cilin administrata Tatimore ka përcaktuar se [redacted] me pronar [redacted] është person përgjegjës – pronar përfitues me tatimpaguesin me borxhe tatimor te pashlyera ne biznesin [redacted]

Referuar nenit 16 pika 1 dhe 2 Shaban Mullallari nuk ka qenë person përgjegjës për biznesin [redacted] ka asnjë ndërlidhje në menagjimin dhe as nuk ishte drejtor i kësaj kompanie, ATK nuk e ka vërtetuar me një kontratë apo në ARBK, dëshmi gjegjëse se [redacted] është apo është person përgjegjës për [redacted], nga kjo rrjedh se ATK ka mbivendosur mb [redacted] konkretisht mbi biznesin që udhëheq [redacted] SHPK një ndërlidhje mes bizneseve e cila në realitet nuk ekziston. Departamenti i mbledhjes iu është referuar nenit 16 pikave 1,2,3,4 pa bazë, pa fakte sepse biznes [redacted] adresën e njëjtte të operimit nuk e ka sikur [redacted]

Me qëllimi të marrjes se një vendimi te drejte Divizioni i Ankesave ka marr informata nga Drejtoria e mbledhjes se borxhe , te cilët përnes raporteve Au05 na dëshmojnë për përpjekjet e këtij departamenti për mbledhjen e borxheve .

Administrata Tatimore – Divizioni i Ankesave, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave në lëndë si dhe pretendimeve ankimore konstaton se: Ankesa e tatimpaguesit është e pa bazuar.

Divizioni i Ankesave pas vlerësimit të provave materiale në shkresat e lëndës si: Raportet AU05 të datës 22/03/2022 , 17/10/2022 , 26/10/2022 , 28/10/2022, Raporti i intervistës për te përcaktuar personin përgjegjës , vlerësimit të provave të bashkangjitura ankesës së dorëzuar me shkrim, dhe analizimit të pretendimeve ankimore vendos se ankesa e tatimpaguesit është e pa bazuar.

Dispozitivi i këtij Vendimi të Divizionit të Ankesave është i mbështetur në faktet në vijim:

Tatimpaguesi konteston përcaktimin e personit përgjegjës [redacted] për biznesin e babait te [redacted] shlyerjen e obligimeve tatimore ne vlere prej 77,219.22 € për periudhat tatimore 2016,2017,2018.

Divizioni i Ankesave vendos se pretendimi i tatimpaguesit është i pa bazuar, këtë vendosje e mbështet ne Neni 16 i Ligjit 03/L-222 paragrafi 1
"Përfaqësuesit përgjegjës të personave fizik, juridik, ortakërive dhe menaxherët apo drejtorët e shoqatave të pa inkorporuara apo organizatave, duhet t'i përmbushin obligimet tatimore për personat, ortakëritë dhe shoqatat apo organizatat që ata i përfaqësojnë ose i menaxhojnë. Nëse shoqatat apo organizatat nuk kanë menaxher apo drejtorë, anëtarët e tyre apo partnerat duhet t'i përmbushin obligimet sipas fjalisë 1-rë të këtij paragrafi."
Posaçërisht, ata duhet të sigurohen se tatimet janë paguar nga fondet që i menaxhojnë.
Bazuar nga informata e dërguara nga Drejtoria e mbledhjes se borxheve ne raportin AU05 te datës 22/03/2022 tatimpaguesi ka lidh marrëveshje për pagese te obligimeve tatimore .
Tatimpaguesi nuk iu ka përmbajt këtë marrëveshje dhe nuk i ka bere pagesat për këstet e përcaktuara . Po ashtu pavarësisht përpjekjeve te zyrtareve te Administratës Tatimore , tatimpaguesi nuk ka bashkëpunuar dhe nuk i ka bere këto pagesa .
Divizioni i Ankesave konstaton se me te drejte është bere përcaktimi si person përgjegjës i [redacted] , njëhereit pronar i biznesit " [redacted] pasi qe ne vizitën e realizuar tek subjekti me date 27/10/2022 e pranon se është [redacted] personi përgjegjës për te gjitha transaksionet e biznesit [redacted] duke përfshirë përgjegjësinë për pagesën e faturave , financat e kompanisë , pagesën e faturave komunale , pagesën e qirasë , për transaksionet bankare (tërheqje , deponime , transferuat bankar) , deklarimin e tatimeve pranë ATK-se .

Nga arsyet e theksuar më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi bazuar në nenin 77.2 të Ligjit Nr. 03/L-222, "Për Administratën Tatimore dhe Procedurat", dhe nenin 132/2 të Ligjit Nr. 05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi bazuar në Nenin 3 të Ligjit Nr. 04/L-102 "Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat" 03/L - 222, tatimpaguesi i pakënaqur ka të drejtë që brenda afatit (30) ditësh, nga dita e pranimit të Vendimit të Divizionit të Ankesave, ta kundërshtojë këtë Vendim tek Divizioni Fiskal i Departamentit Administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

DIVIZIONI I ANKESAVE NË PRISHTINË
Nr. 473/22 datë 09/12/2022

Vendimi t'iu dorëzohet :

1. Tatimpaguesit
2. Administratës Tatimore

Udhëheqës i Divizionit të Ankesave
Skender Krasniqi

Kryesuesja e panelit shqyrtues
Ilona Mrasori

